



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.7/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Franciska Zhitia Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të kundërpërbarimit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS SH.A., me seli në Prishtinë, ndaj debitorit të kundërpërbarimit KS “Siguria”, me seli në rr. “Luan Haradinaj” Lam. A. pnr, Prishtinë, me objekt kontesti kthim i mjeteve sipas propozim për kundërpërbarim, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kreditori Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS SHA më datë 08.07.2018, ka paraqitur propozim për kundërpërbarim ndaj debitorit KS “Siguria”, me seli në Prishtinë për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 4,364.23 €.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, duke vepruar sipas propozimit për kundërpërbarim, me aktvendimin CP.nr.1051/18, të datës 22.02.2023, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për procedimin e kësaj çështje, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që, pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim lënda i dërgohet në kompetencë Gjykatës Komerciale në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1830/23, të datës 27.12.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë -

Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit të kundërpërmbartimit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS SH.A., me seli në Prishtinë dhe debitorit të kundërpërmbartimit KS “Siguria”, me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që, për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kundërpërmbartimit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS SH.A, me seli në Prishtinë, më datë 08.06.2018, ka parashtruar propozim për kundërpërmbartim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të aprovohet propozimi i kreditorit të kundërpërmbartimit për kthimin e mjeteve në lartësi prej 4,364.23 €, ashtu që të urdhërohet debitori i kundërpërmbartimit KS “Siguria”, me seli në Prishtinë, që t’ia paguajë shumën e lartcekur. Gjykata duke vepruar sipas propozimit për kundërpërmbartim, me aktvendimin CP.nr.1051/18, të datës 22.02.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje të mëtejme.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore për të vendosur është Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, për këto arsye:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”* Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, parashihet që: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”*. Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore është Gjykata Themelore në Prishtinë, për faktin se palët në këtë çështje përmbartimore kur është lejuar përmbartimi dhe lënda ka qenë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejimin e përmbartimit. Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përmbartimore, ndërsa çështja është në kompetencë të Gjykatës Komerciale, kjo gjykatë do të kishte kompetencë lëndore që të

vendosë për të gjitha mjetet juridike, ashtu siç është përcaktuar me LPP dhe nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale. Mbi bazën e këtyre rrethanave, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkesave të lëndës e bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur sipas propozimit për përmbarim është Gjykata Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.7/2025, datë 24.02.2025

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Lumni Sallauka